

VENDIM
Nr. 393, datë 18.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të fjalisë së pikës 2, të vendimit nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët “... bileta, procesverbale, akte kontrolli, vendim për kundërvajtjen administrative, procesverbal i konstatimit të kundërvajtjes administrative, akt verifikimi, vendim dënimi, vërtetim transporti, bileta për hyrje në zonat e mbrojtura/parqe kombëtare për invalidë dhe automjete, fatura, raporte mjekësore, receta me rimbursim 100%, receta me rimbursim të pjesshëm, receta pa rimbursim, formularë vizite, formularët e procedurave mjekësore, rekomandime, kartela, librezë shëndetësore të lëshuara nga institucione shtetërore, si dhe dokumente të prodhuara e të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përmbajnë numër serial.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama